

VENDIM
Nr. 258, datë 21.12.2020

MBI KORRIGJIMIN E PAGESAVE RREGULLATORE, PËR VITIN 2020, PËR DISA
NGA TË LICENCUARIT E SEKTORIT TË ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 5, pika 5.4 dhe 6, pika 6, pika 6.1.1, 6.4, dhe nenit 7, i “Rregullores për përcaktimin e miratimit të pagesave rregullatore”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020; të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin nr. 135/19 prot., datë 18.12.2020, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, mbi korrigjimin e pagesave rregullatore, për vitin 2020, për disa nga të licencuarit e sektorit të energjisë,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.171, datë 4.11.2020, vendosi: “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2020”;

- Me anë të shkresës nr. 237, datë 16.12.2020, shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. ka kërkuar rishikimin e pagesës rregullatore të vitit 2020, të miratuar me vendimin nr. 171/2020, të Bordit të ERE-s, duke përcjellë pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2019, në të cilat evidentohen të ardhurat e realizuara të shoqërisë;

- Në vijim të kësaj kërke, u krye një rikontroll, prej të cilit rezultoi një pasaktësi lidhur me të ardhurat e marra në konsideratë gjatë llogaritjes së pagesës rregullatore për subjektin “Hydro Seta” sh.p.k.

- Mbas saktësimit të të ardhurave, rezultoi se pagesa rregullatore 2020 për këtë subjekt është llogaritur në një vlerë më të lartë, e si rrjedhojë aplikimi i saj nuk do të ishte i drejtë në aspektin ligjor dhe rregullator, si dhe në frymën e bashkëpunimit reciprok me një të licencuar, në kohën kur pika 3, e vendimit nr. 171/2020, detyron kryerjen e pagesës rregullatore ndaj ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare, të vendimit sipërcituar.

- ERE vlerësoi të nevojshme të vijonte me kontrollin e të ardhurave, të marra në konsideratë për përcaktimin e pagesave rregullatore, dhe për shoqëritë e tjera të licencuara nga ERE nga ku rezultuan dhe pasaktësi të tjera.

- Gjatë këtij kontrolli, u evidentua se është llogaritur pagesë rregullatore dhe për shoqëri të cilave i ka përfunduar licenca gjatë vitit 2020, si dhe një shoqëri e cila nuk ishte përfshirë në llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2020.

- Pasaktësitë e konstatuara gjatë kontrollit mbi regjistrimin e të ardhurave që kanë shërbyer për llogaritjen e pagesës rregullatore, lidhen me faktin se një pjesë e këtyre subjekteve nuk kanë raportuar llogaritë e ndara nga aktivitetet e tjera që ata ushtrojnë, detyrim ky i përcaktuar në pikën 1, të nenit 35, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, e si rrjedhojë të ardhurat e marra në konsideratë nuk kanë qenë nga ushtrimi i aktivitetit të licencuar.

- Për një pjesë të të licencuarve, të cilëve i janë konstatuar pasaktësi në llogaritje, ERE ka përlllogaritur këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga publikime zyrtare, në zbatim të pikës 6.4, të “Rregullores për përcaktimin e miratimit të pagesave rregullatore”, për arsye të mos dërgimit të pasqyrave financiare të plota/audituar, si një detyrim i përcaktuar në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Për një pjesë të të licencuarve u evidentuan disa lapsuse në regjistrimin e të ardhurave, të cilat kanë ardhur për shkak të kushteve të vështira të punës *online*, të shkaktuara prej pandemisë COVID-19.

- Mbas saktësimit të të ardhurave, rezulton një rishpërndarje e re e pagesës rregullatore 2020, jo vetëm për subjektet, subjekt i këtij vendimi, por dhe për të gjithë të licencuarit e tjerë që operojnë në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- Efektet e korigjimit të pagesës rregullatore për të licencuarit e tjerë, të cilët të ardhurat e konsideruara sipas përcaktimeve të pikës 6.1.1, janë regjistruar saktë, do të korigjohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Korigjimin e pagesës rregullatore për vitin 2020 vetëm për shoqëritë e licencuara të përcaktuara në pikën 1, të vendimit nr. 171, datë 4.11.2020, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Diferencat që rezultojnë nga korigjimi i pagesës rregullatore të vitit 2020, për shoqëritë e licencuara sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, për efekt të buxhetit të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 22, datë 30.1.2020, të Bordit të ERE-s, do të alokohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse të të gjithë të licencuarve të sektorit të energjisë që nuk janë subjekt i këtij vendimi.

3. Të licencuarit, subjekt i këtij vendimi (sipas tabelës bashkëlidhur), duhet të kryejnë pagesat rregullatore ndaj ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare i këtij vendimi, në të kundërt, ERE, mbështetur në nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj

4. Drejtoria e Financës dhe IT-së të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, ose brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

I	Liçensë për prodhim	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	"ELEKTRO LUBONJA" sh.p.k	7,707	11,790
2	"Sarolli" sh.p.k	37,083	83,098
3	"Hidropowerplant Construction" sh.p.k.	168,693	371,137
4	"C & S ENERGY" sh.p.k	672,660	690,281
5	DAAB Energy Group sh.p.k	121,030	125,530
6	"EUROBIZNES" sh.p.k	4,523	102,595
7	"Hydro Seta" sh.p.k	413,203	1,969,594
8	"DERBI – E" sh.p.k.	20,776	109,125
Total		1,445,675	3,463,152

V	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	"Electral" sh.p.k	-	100,000
Total		-	100,000

VI	Liçensë për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	100,000	-
Total		100,000	-

VI	Liçensë për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
1	"Gaea-Energjia alternative e gjelber" sh.p.k	-	100,000
2	"Electral" sh.p.k	-	100,000
3	"Anio Oil&Gas" sh.p.k	-	258,329
Total		-	458,329

Emertimi		Pagesa Rregullatore 2020 e saktësuar	Pagesa rregullatore 2020 (Vendimi 171/2020)
Total		1,545,675	4,021,480